

# BULETIN

UJI I KOSOVËS  
#ujëpërkosovën

№5

## NJOHURI TË REJA PËR RESURSET UJORE TË DISPONUESHME NË KOSOVË

Me dëshirën për të hedhur dritë të re mbi disponueshmërinë e burimeve ujore në hapësirë dhe kohë në Kosovë, Programi MIRU-K mbështeti një vlerësim më të avancuar të bilancit të ujit në mbarë vendin. Duke synuar katër basenet kryesore, studimi tani ofron njohuritë sistematike më të përditësuara mbi burimet e disponueshme ujore.




Integrated Water Resources  
Management in Kosovo

# PROFESOR FLORIM GRAJÇEVCI

DEKAN I FAKULTETIT TË NDËRTIMTARISË  
UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

## FAKULTETI I NDËRTIMTARISË - GJENERUES I DIJES DHE SHKENCËS



Jam shumë i lumtur të shkruaj editorialin për Buletinin e Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore të Kosovës (MIRU-K) dhe të prezantoj punën e Fakultetit të Ndërtimtarisë (FN) për publikun. Duke funksionuar në kuadër të Universitetit të Prishtinës, FN është institucioni lider arsimor dhe shkencor në fushën e ndërtimtarisë në Kosovë.

Standardet e larta në mësimdhënie arrihen përmes punës sonë kërkimore të realizuar nga stafi ynë akademik. Stafi akademik i prezanton rregullisht gjetjet e hulumtimeve në konferenca ndërkombëtare dhe publikon punime shkencore në revista prestigjioze. FN-ja ka arritur të sigurojë mbështetje për programin e vet për hulumtime shkencore përmes granteve/programeve të suksesshme dhe projekteve ndërkombëtare. Përmes projektit shkencor "InWaterSense" (Rrjete me Sensorë Inteligjentë Wireless për Monitorimin e Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore), i financuar nga Bashkimi Evropian (BE), FN-ja ka krijuar bashkëpunim ndërmjet studiuesve në Kosovë në fusha të ndryshme, si inxhinieria hidraulike dhe inxhinieria kompjuterike, duke përfshirë Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës dhe universitetet partnere të BE-së.

FN-ja është pjesë e një tjetër projekti të quajtur GEOBIZ dhe i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të ERASMUS+ KA2, për Ngritjen e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë, i cili synon të vazhdojë ngritjen e cilësisë së kurrikulave përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, sektorit publik dhe bizneseve private. Institucioni dhe akademikët kontribuojnë në nevojat e tregut të punës, i cili është prioriteti ynë kryesor.

Trendet e urbanizimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të ekonomisë dhe industrisë së vendit tonë kanë sjellë rritjen e kërkesave për resurse natyrore dhe veçanërisht për ujë. Kjo kërkesë në rritje për ujë dhe degradimi i cilësisë së ujit përbëjnë një kërcënim të vazhdueshëm për resurset tona ekzistuese ujore. Për të menaxhuar këtë kërcënim do të nevojitet personel shumë i kualifikuar i cili do të jetë përgjegjës për planifikimin, projektimin dhe funksionimin e sistemeve të ujit. Për t'i adresuar këto sfida, në partneritet akademik me Universitetin e Pejës, FN-ja ka hartuar një program studimi Master me një qasje ndërdisiplinore dhe të integruar për të ofruar ngritje të qëndrueshme të kapaciteteve njerëzore.

Për programin MSc në Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore, Universiteti i Prishtinës tashmë ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për zbatim me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), përmes Programit Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore-Kosovë. Programi ka nënshkruar një marrëveshje të mëtejshme me TH Köln, e dedikuar për mbështetjen e MSc në MIRU përmes një procesi të akreditimit, ligjëratave, praktikave dhe teza diplomash. Programi synon ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve ujore në nivel kombëtar. Nga SDC do të ofrohet investimi për laboratorët e inxhinierisë hidroteknike dhe mjedisore dhe pajisje të tjera.

Programi i studimit MSc në MIRU përgatit studentët me njohuri të gjera mbi inovacionet shkencore dhe teknike në këtë fushë të specializuar duke i vendosur ata në tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës. Ky program Master është konceptuar në mënyrë për të ndihmuar Kosovën të përmirësojë menaxhimin e përgjithshëm të burimeve ujore, duke kaluar nga qasjet tradicionale në konceptet bashkëkohore holistike që marrin parasysh aspekte të shumta dhe mbështeten në integrimin e arritjeve të disiplinave të ndryshme shkencore.



FN-ja do ta vazhdojë partneritetin e vet me Bordin Industrial të FN-së, dhe do t'i përdorë Memorandumet ekzistuese të Mirëkuptimit me institucionet publike dhe private. Projektet në vazhdim e sipër dhe ato të reja Erasmus do të ofrojnë shkëmbim njohurish, të tilla si seminare, takime, trajnime, si dhe lëvizshmëri të studentëve dhe stafit.

*"Kushdo që mund të zgjidhë problemet e ujit do të jetë i denjë për dy çmime Nobel - një për paqen dhe një për shkencën."* - John F. Kennedy



INTERVISTË ME

## Z. BATON BEGOLLI

KËSHILLTAR - KËSHILLI NDËRMINISTOROR  
PËR UJËRAT (KNMU), KOSOVË

### ***Kush është Baton Begolli dhe sa kohë keni qenë i përfshirë në sistemin për menaxhim të resurseve ujore të Kosovës?***

Unë jam inxhinier mjedisor i diplomuar për ujëra në Universitetin Teknik të Lindjes së Mesme në Ankara, Turqi. U ktheva në Kosovë në vitin 1999 për t'i shërbyer vendit tim. Më vonë, ndërkohë që punoja për institucionet qendrore, kuptova se kishte nevojë për t'u zhvilluar më tej në aspektin akademik në politikën për menaxhim të mjedisit, kështu ndoqa studimet për Msc në Sistemet për Vlerësim të Ndikimit Mjedisor, Auditim dhe Menaxhim, në Universitetin e Anglisë Lindore në Norwich, Mbretëria e Bashkuar.

Karriera ime në Kosovë fillimisht më çoi në sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Megjithatë, progresi që u vu re në atë kohë u arrit duke lidhur menaxhimin e duhur të mbeturinave me mbrojtjen e resurseve ujore. Shumë shpejt u përfshiva në reformat e sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovës dhe me krijimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, iu bashkova si Drejtor i Departamentit Burimeve të Ujërave.

### ***Pse u krijua KNMU dhe çfarë roli luan në strukturën e Qeverisë së Kosovës dhe qeverisjen e ujërave në përgjithësi?***

Sektori i ujit në Kosovë që herët u nda. Burimet ujore ishin përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa shërbimet e ujit fillimisht ishin përgjegjësi e institucioneve të UNMIK-ut. Pas pavarësisë ato iu dorëzuan Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (fillimisht Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave). Më pas kishte organe të tjera me rol në sektorin e ujit, si bujqësia, shëndeti publik, etj., kështu që lindi nevoja për një organ gjithëpërfshirës për të bashkërenduar interesat e përgjithshme të sektorit në zyrën më të lartë ekzekutive.

Për këtë qëllim, qeveria krijoi Task Forcën e saj të Ujit (TFU), e cila u mbështet nga qeveria zvicerane. Të gjithë akterët e sektorit të ujit e njohën efikasitetin dhe ndikimin e tij të rëndësishëm në sektorin e ujit, dhe në vitin 2013 TFU u transformua me ligj në Këshillin Ndërmintor të Ujit. KNMU-ja kryesohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga Ministrat e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura; të Ekonomisë; të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe të Financave, Punës dhe Transfereve. Prandaj është si një organ politik që reflekton menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe parimet NEXUS.

KNMU ofron një forum për mbledhjen dhe vlerësimin e përvojave pozitive të sektorit të ujit, por edhe sfidave të zbatimit, komunikimit dhe bashkëpunimit. Për më tepër, KNMU e ofron një platformë për zhvillimin e politikave për reformimin e sektorit të ujit duke marrë parasysh perspektiva të ndryshme, nga përdoruesit e ujit deri tek ofruesit e ujit. KNMU gjithashtu zhvillon dhe miraton politikën e nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e reformave dhe investimeve në sektorin e ujit.

### ***Me ndihmën e donatorëve, Qeveria e Kosovës ka iniciuar plane shumë ambicioze për përmirësimin e menaxhimit të burimeve ujore. Çfarë hapash konkretë janë ndërmarrë për të adresuar sfidat prioritare dhe çfarë duhet të presim të shohim në vitet në vijim?***

Fokusi fillestar i Qeverisë ishte përmirësimi i sektorit të furnizimit me ujë. Situata e trashëguar pas luftës ishte një shkatërrim dhe neglizhencë për dekada, kështu që nga rreth 50% qasje në furnizimin me ujë dhe 27% qasje në kanalizim, situata u përmirësua ndjeshëm në mbi 90% qasje në furnizimin me ujë (duke përfshirë sistemet rurale që aktualisht nuk menaxhohen nga shërbimet publike) dhe rreth 70% qasje në kanalizime. Me këtë arritje, fokusi është zhvendosur më shumë drejt trajtimit të ujërave të zeza në komunat më të mëdha fillimisht, dhe në mbrojtjen e burimeve ekzistuese ujore si dhe zhvillimin e digave të reja për të përmbushur sigurinë ujore për rajonet me stres më të madh ujor.

Tani ka shumë aktivitete në përmbushjen e sfidave gjithnjë në zhvillim: në sektorin e shërbimeve të ujit këto janë zhvillimi gradual i menaxhimit të ujërave të zeza dhe menaxhimi i llumit shoqëruar në Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren, dhe po kërkohen fonde për 10-12 komunitet e ardhshme më të mëdha. Fokusi për burimet ujore është vlerësimi i potencialit për diga të reja dhe fillimi i ndërtimit të tyre, p.sh. në Firajë, Kamenicë, etj., si dhe në menaxhimin e përgjithshëm të burimeve ujore duke zhvilluar plane të menaxhimit të pellgjeve lumore, harta të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet, monitorimin e ujërave nëntokësore, etj. Një fushë tjetër e veçantë me interes është zhvillimi i grupit të ri të profesionistëve të rinj për t'u përfshirë në mënyrë aktive në projektet që ofrojnë mundësi të rralla dhe për të ndërtuar njohuritë lokale për të përballuar sfidat e së ardhmes.

***Për rreth dy dekada, qeveria zvicerane ka qenë donator kyç në sektorin e ujit në Kosovë. Sa i rëndësishëm është ky bashkëpunim mes Qeverisë së Zvicrës dhe Kosovës për çështjet e menaxhimit të ujërave?***

Qeveria zvicerane ka qenë një partner instrumental jo vetëm për shkak të madhësisë së kontributeve të saj, por, sipas mendimit tim, kryesisht për shkak të qasjes së tyre. Mbështetja zvicerane në sektorin e ujit manifestohet në çdo nivel të sektorit: furnizimi me ujë dhe kanalizimet rurale; përmirësimi i performancës së ndërmarrjeve të ujësjellësit, fillimisht në Kosovën juglindore dhe tani në të shtatë Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit; mbështetje institucionale për menaxhimin e integruar të burimeve ujore; angazhimi i shoqërisë civile; zhvillimi akademik; fuqizimi i profesionistëve të rinjve dhe mbështetje për nivelin më të lartë politik, KNMU. Kjo mbështetje gjithëpërfshirëse për sektorin lejon akordimin e duhur të bashkëpunimit dhe koordinimit të intervenimeve.

***Ku e shihni rolin dhe potencialin transformues të Programit IWRM-K në vazhdim ndërmjet Zvicrës dhe Qeverisë së Kosovës?***

Për një kohë të gjatë, burimet ujore kanë qenë hallka më e dobët në sektorin e ujit dhe Programi nuk mund të kishte ardhur në një kohë më të mirë. Me klientin e përkushtuar, Autoritetin e Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) dhe organe të tjera të Ministrisë, Programi po ecën mjaft mirë. Shumë procese të injoruara më parë janë fuqizuar dhe po bëhet punë konkrete – për shembull në drejtim të përmirësimit të planifikimit dhe monitorimit të burimeve ujore, vendosjes së një fuqie punëtore të re tek një klient me staf të pamjaftueshëm, fillimit të një programi Master në MIRU, në mënyrë aktive angazhimi i palëve të interesit në nivel pellgu dhe shumë aktivitete më të rëndësishme që duhen përfunduar apo planifikuar, kryesisht planet e menaxhimit të pellgjeve lumore për pellgjet e Ibrit, Lepencit dhe Moravës së Binçës. Programi ka potencialin për të çuar sektorin e burimeve ujore në një nivel tjetër gjatë kësaj faze dhe më gjerë.

***Ku do të dëshironit ta shihnit Kosovën në dhjetë vitet e ardhshme kur bëhet fjalë për qeverisjen e ujërave?***

Do të doja të shihja reformat e sektorit të ujit të përfunduar deri më tani – të tilla si Kompanitë Rajonale të Ujit, Rregullatori i pavarur i Shërbimeve të Ujit përgjegjës para Parlamentit dhe ndarja institucionale midis burimeve ujore dhe shërbimeve ujore – të mirëmbahen dhe forcohen. Do të doja të shihja një kuadër të plotë profesionistësh të rinj nëpërmjet organet ujore dhe dimensionin transformues dhe inovativ që do të sillnin. Do të doja të shihja ndërtimin e digave të Firajës dhe Kamenicës dhe një vizion të qartë për nevojat e tjera për zhvillimin e digave. Do të doja të shihja organet ujore në Qeveri – siç janë ARPL, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, Inspektorati dhe Instituti i Shëndetit Publik – të kenë gjithë respektin që meritojnë dhe të kenë personel të plotë. Do të doja të shihja fundin e të paktën dy problemeve të pakuptueshme: hedhjen e mbetjeve të ngurta në lumenj dhe shfrytëzimin e egër të parregulluar të lumenjve. Do të doja të shihja impiante funksionale të trajtimit të ujërave të zeza të ngritura në të gjitha vendbanimet kryesore dhe fillimin e punës për 10 qytetet vijuese sipas madhësisë. Nëse i shoh të gjitha këto arritje, jeta ime do të ketë shërbyer për diçka të mirë.

# Njohuri të reja të thelluara për

## RESURSET UJORE TË DISPONUESHME NË KOSOVË

Me dëshirën për të hedhur dritë të re mbi disponueshmërinë e burimeve ujore në hapësirë dhe kohë në Kosovë, Programi i Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore mbështeti një vlerësim më të avancuar të bilancit të ujit në mbarë vendin. Duke synuar katër basenet kryesore (Ibër, Morava e Binçës, Drini i Bardhë dhe Lepenci), studimi ofron njohuritë sistematike më të përditësuara mbi burimet e disponueshme ujore dhe nivelet aktuale dhe të parashikuara të stresit ujqor, duke marrë parasysh tendencat e përdorimit të ujit dhe efektet e ndryshimeve klimatike.

Analiza e bilancit të ujit u realizua nëpërmjet aplikimit të platformave të ndryshme të modelimit hidrogjik të cilat i konvertojnë të dhënat e hyra (p.sh. reshjet, shfrytëzimi i tokës, shkarkimi, nxjerrja, deponimi) në rezultate me shumë qëllime (p.sh. burimet e disponueshme ujore, rrjedhjet). Një nga ndryshimet kryesore në krahasim me analizat e mëparshme të ngjashme ishte qasja e 'të menduarit inovativ' kur bëhej fjalë për adresimin e boshllëqeve të të dhënave. Aftësia e Programit për të plotësuar boshllëqet kryesore të të dhënave historike (p.sh. të dhënat klimatike), i bën analizat shumë më të rëndësishme nga pikëpamja aktuale e menaxhimit të burimeve ujore.






Figura 1. Përafrimi i lartë ndërmjet të dhënave hidrogjike të modeluara dhe të vëzhguara – dëshmi e saktësisë së modelit (pellgu i lumit Lepenci)



Përdorimi i një serie të gjatë të dhënash klimatike të bazuara në satelit që shtrihen deri në momentin e studimit dhe qasja në të dhënat e matura nga të gjitha vendet fqinje (p.sh. në shkarkimin e lumenjve ndërkufitarë), u mundëson modeleve të kapin tendencat e vazhdueshme dhe të gjenerojnë parashikime më të besueshme për të ardhmen.

Figura 2. Nivelet e stresit ujqor të Kosovës në kontekst rajonal të shprehura përmes Indeksit të Stresit Ujqor Falkenmark (ujërat e disponueshme në  $m^3$ /banor/vit) (<https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/figures/annual-water-availability-per-person>)

Me më pak se 1,600 m<sup>3</sup> ujë për kokë banori në vit, Kosova përballet me nivele të konsiderueshme të stresit të cilat pritet të rriten sipas një skenari "business-as-usual", d.m.th. nëse nuk merren masat e duhura për të përshtatur më mirë burimet ujore të disponueshme dhe të nevojshme. Situata bëhet e ndërlukuar kur merret parasysh pabarazia e disponueshmërisë së burimeve ujore brenda vendit dhe tendencat negative të parashikuara të përcaktuara nga skenarët klimatikë mbizotërues.



**Figura 3. Asimetria brenda vendit e niveleve aktuale të stresit të ujit kundrejt atyre të parashikuara (vitet 2081-2100) sipas skenarit klimatik RCP8.5 (rrjedhe e zakonishme) bazuar në Indeksin e Stresit të Ujit Falkenmark**

Studimi tashmë po futet në dokumente të rëndësishme të planifikimit (p.sh. Planet e Menaxhimit të Pellgjeve Lumore) dhe projekte të tjera përkatëse. Duke njohur fuqinë e platformave të modelimit të përdorura, veçanërisht SWAT, Programi aktualisht po i përmirëson ato për të simuluar jo vetëm ujin, por edhe proceset e transportit të erozionit dhe sedimentit, si dhe ngarkimin e ndotësve në trupat ujorë nga një gamë e gjerë pikash dhe burimesh difuze.

Modelet e përmirësuara do të përdoren më pas për të simuluar efektet e skenarëve të ndryshëm të menaxhimit, duke përfshirë praktikën e bazuar në tokë, praktikën strukturale dhe inputet e ndotjes. Kjo do t'i mundësojë jo vetëm Programit, por më e rëndësishmja, institucioneve të vendit, të marrin vendimet më të mira për masat e synuara që do të maksimizojnë mbrojtjen e burimeve ujore dhe efikasitetin e përdorimit.

Përfitimet për vendin do të varen nga shkalla në të cilën modeli do të adoptohet nga autoritetet. Programi e lehtëson këtë duke transferuar bazat e të dhënave dhe modelet e plota së bashku me trajnimin e synuar për aplikimin e modelit për stafin teknik të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

# ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE JANË PALË TË RËNDËSISHME TË INTERESIT NË QEVERISJEN E UJËRAVE NË KOSOVË

Është një opinion i pranuar në mbarë botën që qeveria, publiku i gjerë dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) duhet të njohin vlerat e përbashkëta dhe të pranojnë përgjegjësi të përbashkëta duke përfshirë burimet njerëzore për arritjen e qëllimeve të përbashkëta të menaxhimit të ujit. Një bashkëpunim i tillë maksimizon pikat e forta të të gjitha palëve të interesit.

Duke ndjekur këtë logjikë, forcimi i rolit të OSHC-ve në menaxhimin e burimeve ujore është një pjesë thelbësore e Programit të Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore (MIRU) të Kosovës.

Për të përmbushur këtë detyrë, Programi ka nisur një Skemë Grantesh për OSHC-të, ku ju ofron grante në mbështetje të iniciativave në përputhje me parimet dhe qasjet e MIRU.

Skema e granteve do të zbatohet paralelisht dhe në ndërlidhje me një sërë iniciativash të planifikimit, ngritjes së kapaciteteve dhe intervenime pilot të mbështetur nga Programi. Skema e granteve do të fokusohet në objektiva të tillë si:

*\* ndihma për shndërrimin e teorisë në praktikë duke prodhuar rezultate të prekshme për palët e interesit*

*\* zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve në mesin e OSHC-ve më premtuese që mund të ndikojnë në të ardhmen e MIRU në Kosovë*

*\*ndihma për rritjen e njohurive të gjera dhe vetëdijesimit për sfidat dhe përgjigjet e menaxhimit të ujërave*

*\* lehtësimi i replikimit dhe shkallëzimit të arritjeve të programit dhe mësimave të nxjerra*

E konceptuar në këtë mënyrë, Skema e Granteve për OSHC-të synon të arrijë rëndësi, efektivitet dhe efikasitet të lartë si parakushte kyçe për ndikimet e dëshiruara dhe qëndrueshmërinë e rezultateve.

Pritshmëritë e programit janë që OSHC-të – veçanërisht organizatat mjedisore – të tregojnë kreativitet dhe të ofrojnë ide inovatore në propozimet e tyre, duke përfshirë synimin e menaxhimit të burimeve ujore në nivel lokal, mobilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit, përfshirjen sociale dhe integrimin gjinor, dhe zhvillimin e qëndrueshëm.





## PËRMIRËSIMI I MONITORIMIT TË UJIT NË KOSOVË

Me ndryshimin e klimës në dy dekadat e fundit në botë dhe Kosovë, ne kemi parë se informacioni në dispozicion dhe të dhënat e përpunuara janë vendimtare për reagime efektive ndaj kushteve të motit dhe menaxhimin dhe përdorimin racional të burimeve ujore. Në një situatë të tillë, ngritja dhe funksionimi i vazhdueshëm i shërbimeve hidrometeorologjike është thelbësor në proceset e menaxhimit. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) është i rëndësishëm për jetën e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, resurset ujore dhe mbrojtjen e mjedisit.

IHMK po bën përpunim të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve monitoruese në të gjithë vendin. Për shembull, si pjesë e Programit të Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore të Kosovës (MIRU-K), stafi i IHMK ka zotëruar metodat analitike për zbulimin e ndotësve organikë në mostrat e ujit. Pajisjet e sofistikuar të disponueshme në IHMK tani janë në përdorim për të mirën e menaxhimit të burimeve ujore.

Përveç kësaj, Programi MIRU-K ofroi pajisje monitoruese hidrologjike më të fundit (një profilues akustik i rrymës Doppler) për të matur shkarkimin në lumenj dhe përrenj pa njehsorë. Të dhënat e gjeneruara nga pajisjet do të ndihmojnë në një vendimmarrje më të mirë në lidhje me përdorimin e ardhshëm të ujit dhe zbutjen e rrezikut nga përmytjet. Stafi i IHMK ndoqi trajnimin mbi përdorimin e pajisjeve nga SEBA Hydrometrie GmbH & Co. KG nga Gjermania.



# NJOHURI TË REJA PËR MENAXHIM MË TË MIRË TË BURIMEVE UJORE

Duke pranuar rëndësinë e investimit tek Profesionistët e Rinj të Ujit (PRU), Shoqata Ndërkombëtare e Ujit vëren se:

"PRU-të ofrojnë një dritare drejt së ardhmes dhe me përfshirjen dhe mbështetjen e tyre aktive ne mund t'i inkorporojmë prioritetet e tyre në praktikën tonë aktuale."

"Puna së bashku me PRU-të jo vetëm që ul ngarkesën tuaj të punës, por gjithashtu ju detyron të rimendoni dhe diskutoni idetë tuaja me dikë me një qasje të ndryshme, e cila në thelb është e vlefshme."

Sigurisht se është një lajm i shkëlqyer që Profesionistët e Rinj të Ujit të Kosovës (PRU-K) po tregojnë entuziazëm në thithjen e njohurive të reja teknike dhe zhvillimin e organizimit të tyre. Si pjesë e përpjekjeve për konsolidim të mbështetura nga Programi i Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore (MIRU), PRU-K tani ka një strategji të re dhe plan pune, rregullore të brendshme, një sistem të menaxhimit të informacionit dhe plan komunikimi së bashku me një identitet të ri të bashkëpunues. Anëtarët e vjetër dhe të rinj të PRU-K po përdorin tashmë njohuritë e reja nga trajnimi i tyre mbi udhëheqjen, inteligjencën emocionale, vetëvlerësimin, vetë-motivimin dhe punën në grup.

## Disa reflektime nga anëtarët e PRU-K:

"Njohuritë që morëm po na ndihmojnë të rrisim kapacitetet tona profesionale dhe të ndërtojmë një platformë si profesionistë të ujit, duke vepruar si një katalizator inovacioni." (Albert Salltakaj)

"Si teknologe e ujërave të zeza, unë fitoj njohuri dhe përvojë të re nga PRU-K, por gjithashtu më është dhënë hapësirë për të inkurajuar të tjerët të mendojnë më shumë për trajtimin e ujërave të zeza." (Ylberinë Baliu)

"Si inxhinier kryesor i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit - Hidroregjioni Jugor, mund të ndaj lehtësisht përvojën time me grupin PRU, por njohuritë që kam marrë këtu janë gjithashtu diçka që mund ta aplikoj në kompaninë e ujit." (Besar Grazhda)

## Dhjetë trajnerë të certifikuar do të përhapin njohuritë e tyre të reja për MIRU në mbarë Kosovën

Një pjesë e rëndësishme e ndërtimit të njohurive për menaxhimin e burimeve ujore është programi i trajnimit mbi MIRU (PT-MIRU). Pas përfundimit të suksesshëm të programit intensiv të trajnimit të trajnerëve në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Administratë Publike, Kosova tani ka 10 trajnerë të certifikuar të MIRU, të cilët janë të gatshëm të ndajnë njohuritë më të reja për menaxhimin e ujit ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit.



# PARTNERITET ME OPERATORË INDUSTRIALË PËR TË REDUKTUAR NDOTJEN INDUSTRIALE

Nivelet e stresit në burimet ujore në Kosovë pritet të rriten në të ardhmen në dritën e krizës klimatike dhe rritjes së kërkesës për ujë për bujqësi, operacione industriale, miniera dhe qendra urbane. Vlerësimet e fundit tregojnë se industrinë dhe vendet industriale në mbarë botën vazhdojnë të jenë ndër kontribuuesit kryesorë në ndotjen e ujit, dhe Kosova nuk bën përjashtim nga kjo. Për të katalizuar adoptimin e teknologjive më të mira të disponueshme në reduktimin e ndotjes industriale, Programi i Integruar i Menaxhimit të Resurseve Ujore të Kosovës (MIRU-K) është në partneritet me operatorë industriale përgjegjës për mjedisin dhe shoqërinë.



Në ciklin e parë të skemës së granteve MIRU-K, Programi bashkëpunoi me tre operatorë të njohur të përpunimit të ushqimit (dy bulmet dhe një përpunim mishi). Pas përvijës pozitive të deritanishme, të paktën tre operatorë të tjerë industrialë do të marrin një mbështetje të tillë, duke dhënë shembuj që mund të ndiqen nga operatorë dhe projekte të tjera në të ardhmen.



Nëpërmjet aplikimit të teknologjive moderne, operatorët e përzgjedhur po mbështeten për të reduktuar shkarkimet ndotëse në mjedis. Masat kryesore përfshijnë metoda që ndihmojnë në reduktimin e përdorimit të lëndëve të para dhe energjisë, rritjen e riciklit dhe ripërdorimit të mbetjeve, futjen e produkteve të reja nga materialet e mundshme të mbetjeve, promovimin e përdorimit të teknologjive më të pastra për të reduktuar ndotjen në burim dhe futjen e zgjidhjeve të menaxhimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta.

# GRATË DHE VENDIMMARRJA

në Menaxhimin e Resurseve Ujore



Pika të rëndësishme në vendosjen e barazisë gjinore në menaxhimin e burimeve ujore ishin padyshim Konferenca e Dublinit për Ujërat (1992) dhe Samiti në Rio de Zhaneiro mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm (Partneriteti Global për Ujërat, 2000), ku u përcaktuan kornizat e Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore. Nga katër parimet e Konferencës së Dublinit, Parimi III i Dublinit, përcakton rolin e rëndësishëm që luajnë gratë në sigurimin, menaxhimin dhe ruajtjen e ujërave. Megjithatë, edhe pas tre dekadash, bota është ende larg arritjes së vendimmarrjes proporcionale dhe barazisë gjinore në sektorin e ujërave. Sfidat me të cilat po përballen gratë në lidhje me menaxhimin e ujit tanimë janë përkeqësuar nga pasojat e ndryshimeve klimatike me theks të veçantë në thatësirat dhe vërshimet.

Megjithëse pranohet gjerësisht se gratë luajnë rol kyç në mbledhjen dhe ruajtjen e ujërave për përdorim shtëpiak dhe bujqësor, roli i tyre është ende minimal në procesin e vendimmarrjes, menaxhimit dhe analizës së problemeve që lidhen me burimet ujore. Sipas një studimi të UN Women, i cili u bazua në të dhëna nga 61 vende, në 80% të amvisërive të privuara nga nevojat bazë për ujë, gratë dhe vajzat mbajnë barrën e mbledhjes së ujit.

Prandaj, ekziston nevoja për një integrim efektiv gjinor në qeverisjen e ujit dhe përfshirjen e grave në rolet vendimmarrëse për ujin, sepse gratë jo vetëm që kanë përvojë përkatëse, por gjithashtu kanë një kuptim të thellë të ujit. Njohuritë e marra nga gratë mund të jenë thelbësore në menaxhimin efikas të ujit në të gjitha nivelet vendimmarrëse dhe spektri i aktiviteteve përmes të cilave gratë mund të marrin pjesë në Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore duhet të zgjerohet gradualisht.

Zbatimi i perspektivës gjinore për zhvillimin dhe menaxhimin e ujit është gjithashtu thelbësor kur synohet zhvillimi i qëndrueshëm në kontekstin social, mjedisor dhe ekonomik. Kjo pasqyrohet më së miri në deklaratën përfundimtare të Konferencës Ndërminstrore të vitit 2001 për Ujin e Ëmbël në Bon, e cila thotë se, "Si burrat ashtu edhe gratë duhet të përfshihen dhe të kenë një zë të barabartë në menaxhimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore dhe ndarjen e përfitimeve".\*

\*UN WOMEN. BARAZIA GJINORE NË AGJENDËN 2030: PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJES SË SISTEMEVE TË PËRGJEGJSHME GJINORE PËR UJËRA DHE KANALIZIME. 2018

# #POSTIMETNËRRJETETSOCIALE

Nëse nuk veprojmë tani, përkeqësimi i thatësirave dhe stuhive në disa nga ekonomitë më të mëdha të botës mund të shkaktojë 5.6 trilion dollarë humbje në ekonominë globale deri në vitin 2050. Lexoni se si përshtatja klimatike mund ta ndryshojë këtë.

Më shumë tek @SarojJha001:  
<http://wrl.d.bg/y7cQ50LIB4u>  
@TheGwsp #gwsp2022



United Nations | UN WATER

Uji mund të luftojë ndryshimet klimatike.


Menaxhimi i qëndrueshëm i ujit është thelbësor për ndërtimin e elasticitetit të shoqërive dhe ekosistemeve dhe për reduktimin e emetimeve të karbonit.

Do të nevojiten financime inovative për menaxhimin e burimeve ujore për të ndihmuar në tërheqjen e investimeve, krijimin e vendeve të punës dhe mbështetjen e qeverive në përmbushjen e qëllimeve të tyre për ujin dhe klimën.

#NowReading:  
<https://buff.ly/3ED2WgK>  
#WaterFacts on climate:  
<https://buff.ly/3SDcqwv>

## Ky BULETIN

Mbështetet nga programi IWRM-K i SDC-së i bashkëfinancuar nga Qeveria e Kosovës dhe zbatuar nga Skat Consulting Ltd., St. Gallen, Zvicër dhe Agjencia Austriake e Mjedisit (EAA).

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

**skat** Swiss Resource Centre and  
Consultancies for Development



Integrated Water Resources  
Management in Kosovo



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

ENVIRONMENT  
AGENCY AUSTRIA **umweltbundesamt**<sup>U</sup>

## Na ndiqni

Facebook: [iwrn\\_k](#) Instagram: [iwrn\\_k](#)  
linkedin: [iwrn\\_k](#) twitter: [iwrn\\_k](#)

[www.iwrn-k.com](http://www.iwrn-k.com)

## Na kontaktoni

Skat Consulting Ltd.  
Integrated Water Resources  
Management in Kosovo  
136 Pashko Vasa Street  
Floor I. No.5, Pejton  
Pristina, Kosovo  
Email: [kosovo@skat.ch](mailto:kosovo@skat.ch)